



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1584 Prot.

Tiranë, më datë 15.11.2021

VENDIM
Nr. 636, datë 12.11.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.11.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Rindërtim dhe shtesë kati në objekt ekzitues dhe ndërtim i ri, me funksion hoteleri “La Belle Epoque”, Pogradec”, brenda kufirit të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Pogradecit, me aplikues z. Loran Bellani, projektues restaurator z. Genci Samimi, zhvillues z. Edlir Piliçi;
 2. Subjekti duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 554, datë 18.06.2015 “Për shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj”, Neni 10, Pika 2:
 - Zbatim i punimeve brenda kufirit të Qendrës Historike, të kryhet nga subjekte të licencuara për këtë kategori në restaurim;
 - Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve brenda kufirit të Qendrës Historike të kryhet sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.
 4. DRTK Korçë të kryejë kontrollin teknik gjatë zbatimit të punimeve dhe të raportojë periodikisht pranë Sekretarisë Teknike të IKTK-së;
 5. Subjekti duhet të dorëzojë 2 (dy) kopje fizike të nënshkruara elektronikisht të dokumentacionit tekniko-ligjor pranë Sekretarisë Teknike në IKTK;
 6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 7. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
 8. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

